



SINDIKATA E POLICISË SË KOSOVËS
SINDIKAT KOSOVSKE POLICIJE
KOSOVO POLICE UNION

REFERENCË:	SPK-01/020//22	DATË:05.10.2022
PËR/ZA/TO:	z.Albin Kurti Kryeministër i Republikës së Kosovës z.Xhelal Sveçla Ministër i MPB-ë z.Hekuran Murati Ministër i Financave	
CC:	z. Fehmi Hoti U.D. Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Drejtëpërdrejt	
NGA/OD/FROM:	z.Imer Zeqiri Kryetar i Sindikatës së Policisë së Kosovës	
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë	



Të nderuar,

Rrugëtimi i themelimit të Policisë së Kosovës nuk ka qenë i lehtë, duke marrë për bazë kohën dhe rrethanat në të cilat gjendej vendi ynë Kosova, në atë kohë të vitit 99-të.

Ndërtimit të Policisë së Kosovës si një polici shumetnike dhe demokratike me orientim drejt komunitetit në frymën e institucioneve përfaqësuese, llogaridhënëse dhe demokratike i ka paraprirë edhe vet përkushtimi, vullneti e dëshira e zyrtarëve policorë për t'i shërbyer vendit dhe qytetarëve pa dallime.

Duke vlerësuar se Policia e Kosovës si institucion i sigurisë së vendit, është shumë e nevojshme që të mbështetet dhe përkrahjet, po Ju drejtohem me këtë kërkesë për gjetjen e mundësive të realizimit të kërkesave në vijim:

- Sigurimi shëndetësor e jetësor,
- Implementimi i pesë propozimeve për projekt ligjin e pagave dhe caktimi i koeficientit të njejtë apo i afërt me të FSK-se, për të gjithë punonjësit e Policisë së Kosovës,
- Ligji për pensionimin e parakohshëm,
- Pagesa e orëve shtesë në vazhdimësi,
- Sigurimi/pagesa e shujtës,
- Mbulimi i shpenzimeve të udhëtimit, apo sigurimi i transportit.

Policia e Kosovës që nga themelimi i saj në shtator të 99-tës e deri më tani është e vetmja polici në Rajon dhe më gjerë që nuk ka sigurim shëndetësor e jetësor, kjo çështje është diskutuar shumë herë më parë si çështje me shumë prioritet për punonjësit e Policisë së Kosovës, por pa përkrahjen

financiare nga Qeveria është e pamundur të realizohet, andaj vlerësojmë lartë angazhimin dhe kontributin e Qeverisë në këtë drejtim .

Policia e Kosovës gjatë kryerjes së detyrave dhe autorizimeve policore përballet me rreziqe të drejtëpërdrejta për jetën dhe shëndetin, prandaj është ndër institucionet me rrezikshmërin më të lartë në shoqëri, si në aspektin e shëndetit ashtu edhe në aspektin e rrezikut për jetë.

Puna dhe përkushtimi i pandalshëm në ofrimin e sigurisë, ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike si dhe luftën ndaj krimit, ka bërë që Policia e Kosovës të fitojë besimin e qytetarëve, e të rangojë Policinë si një nga institucionet më të besuara në vend dhe të vlerësuar edhe nga mekanizma ndërkombëtar si një histori suksesi.

Këtë sukses dhe këtë besueshmëri edhe pse pa kushte të mira financiare, pa sigurime shëndetësor e jetësor, Policia e Kosovës e ka arritur përmes zyrtarëve të sajë, të cilët falë angazhimit, punës dhe sakrificës për ti shërbyer vendit dhe qytetarëve të saj, duke e vënë jetën e tyre në rrezik, duke qëndruar në linjë të detyrës me besnikëri dhe trimëri nuk kursyen as jetën e tyre.

Andaj për të vazhduar mbajtjen e lartë të këtij niveli të angazhimit të punonjësve policor, për të parandaluar edhe dorëheqjet nga PK-ja, vlerësojmë se përkrahja dhe mbështetja nga ana e Qeverisë në këtë fazë emergjente është mjaft e nevojshme dhe e domosdoshme.

- **Sigurimi shëndetësor e jetësor**

Rregullimi i aspektit të sigurimeve shëndetësore dhe jetësore për një kohë të gjatë ka qenë edhe peng i miratimit dhe zbatimit të Ligjit për sigurime shëndetësore si Ligj bazë për të gjithë qytetarët duke përfshirë edhe Policinë e Kosovës. Për shkak të ngecjes së zbatimit të këtij ligji, propozojmë që për shkak të nevojave imediate që ka Policia e Kosovës, të gjendet një zgjidhje për organizatën tonë duke pasur parasysh specifikat dhe kushtet e punës në të cilat punon personeli policor.

Duke u bazuar në të dhënat që i kemi deri me tani, ne kemi një numër mjaft të madh të personelit policor të cilët kanë humbur jetën, kanë vdekur, janë lënduar apo edhe kanë probleme shëndetësore të theksuara deri në invaliditet.

Deri me tani në kryerje të detyrës kanë humbur jetën 22 zyrtarë policor (heronj të Kosovës), nga pandemia COVID-19 humben jetën (25) punonjës të Policisë së Kosovës, kanë vdekur në detyrë 324 zyrtarë, 359 zyrtarë policor janë lënduar në kryerjen e detyrave zyrtare, 231 zyrtarë të sëmurë në detyrë, aktualisht me sëmundje të veçanta shëndetësore janë 259 zyrtarë. Deri tani kemi 1273 zyrtarë policor të cilët kanë dhënë dorëheqje vullnetare nga Policia.

Mosha mesatare e personelit policor ka aritur në katërdhjetë e shtatë (47) vjet dhe për punën dhe kërkesat që kërkohen për zyrtarët policor në aspektin e aftësisë fizike dhe mendore është e vështirë për tu mirëmbjtur pa mbështetje shëndetësore të mirë dhe pa sigurim shëndetësor adekuat apo edhe pensionim të parakohshëm.

Në Policinë e Kosovës kemi rreth 9342 punonjës të rregullt duke përfshirë këtu zyrtarët e unifomuar dhe stafin civil. Sindikata e Policisë së Kosovës ka takuar Drejtorin e Byros Kosovare të Sigurimeve me qëllim që të sigurojmë mënyrën dhe koston financiare për implementimin e sigurimit shëndetësor dhe jetësor për punonjësit e Policisë së Kosovës.

Gjatë analizimit të të dhënave kemi vlerësuar se me rreth pesë milion (5000000) euro në vit mund të bëjmë një sigurim shëndetësor për pjestarët e Policisë së Kosovës. Nga oferta kemi kuptuar se është e mundur mbulimi i shpenzimeve për sigurim shëndetësor duke përfshirë: invaliditetin, hospitalizimin, shpenzimet mjekësore si pasojë aksidenti, trajtimet ambulatorore, medikamentet, shërbimet dentare, shërbimet optike, shërbimet e dëgjimit, shërbimet e maternitetit, transportet

autoambulance etj. Ndërsa për sigurimin jetësor mbulimi i humbjes së jetës natyrore dhe humbjes aksidentale të jetës.

Nëse nga Qeveria e Republikës së Kosovës ndahen mjetet e kërkuara prej pesë milion euro, për secilin vit në vazhdimësi, mund të bëjmë sigurimin shëndetësor dhe jetësor për pjestarët e Policisë së Kosovës, e cila mund të filloj implementimin e saj brenda një periudhe të shpejtë kohore.

Sigurimi shëndetësor për institucionin e vetëm të sigurisë në vend do të duhej të bëhej shumë vite më parë apo së paku nga shpallja e Pavarësisë së Republikës së Kosovës, prandaj është nevojë jetike që kjo të bëhet edhe tani si dhe do të ishte nder dhe respekt për Qeverinë e Republikës së Kosovës.

Andaj besojmë dhe shpresojmë në mbështetjen Tuaj dhe të qeverisë së Republikës së Kosovës për alokimin e mjeteve në shumë prej pesë (5000000) milion euro, për të mbështetur Policinë e Kosovës për realizimin e sigurimit shëndetësor dhe jetësor.

- **Implementimi i pesë propozimeve për projekt ligjin e pagave**

Po ashtu sa i përket projektligjit për paga i cili është tepër i rëndësishëm për punonjësit e PK-së, në vijim ju paraqesim pikat mbi propozimet të cilat kerkojmë të implementohen, e të cilat janë të domosdoshme për punonjësit e saj, e të cilat me sqarimet e detajuara të propozimeve të poshtëshenuara janë dhënë edhe nga vet Policia, e të cilat i mbështet fuqishëm Sindikata e PK-së.

Propozimi I:

Neni 24 i Projektligjit shtesa për kushte të tregut:

Propozojmë që shtesa të jetë e përcaktuar në mënyra nominale me përqindje sikur që është përcaktuar tek shtesat për të zgjedhurit neni 23, shtesa për funksionale për nëpunësit e arsimit universitar Neni 32; shtesa për nëpunësit e sistemit shëndetësorë neni 33 etj.

Propozimi II:

Neni 26 i Projektligjit - Shtesa për kushte specifike të punës:

Sa i përket këtij neni ne mendojmë se kjo duhet të caktohet me % fikëse sikundër është caktuar në shumë shtesa tjera. Prandaj propozojmë që kjo shtese të jetë deri në 40% të pagës bazë.

Propozimi III

Neni 36 i Projektligjit - Kompensimi për kujdestari, punën gjatë natës dhe jashtë orarit të punës

Dispozita e cila parasheh kompensimit me përqindje deri 1 % siç ose pushim siç e ka paraparë paragrafi 2 i këtij projektligji paraqet vështirësi në zbatim në Policinë e Kosovës Sipas përlllogaritjeve në kuadër të buxhetit aktual të Policisë së Kosovës pjesëmarrja e kompensimit (puna jashtë orarit, ndërrimet e natës dhe kompensimet tjera) në Polici në kuadër të një viti shprehur në vlerë monetare është 10,166,844.45 mil euro apo në përqindje 12.53% e vlerës së buxhetit të Policisë. Në bazë të kësaj del se shumica e kompensimeve në Polici në bazë të projektligjit do të duhej të bëhet me kompensim me pushim dhe për shkak të angazhimeve operationale siç u tha me lartë në disa situata është shumë e vështirë për tu realizuar. Sipas kalkulimeve të tanishme fondi i ndarë për punë jashtë orarit aktualisht është me 6.87% të buxhetit të PK-së; pjesëmarrja në pagesat e ndërrimit të natës është 2.01% e buxhetit total të PK-së prandaj ne propozojmë të fshihet paragrafi 2 i këtij projektligji i cili paraqet kufizim të kompensimit vetëm në përqindje prej 1% të fondeve totale të organizatës buxhetore.

Propozimi IV

Shtojca Nr. 5 e Draft ligjit - grupi dhe klasa për stafin e uniformuar:

Duke u bazuar në detyrat me rrezikshmëri të lartë, propozojmë në kuadër të përcaktimit të koeficientit të bëhet një harmonizim në mes të gradave në dy institucionet atë të Policisë dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Propozimi V:

Shtojca Nr.8 e Projektligjit - nëpunësit e shërbimit civil, nëpunësi i administratës së shërbimit publik dhe nëpunësi teknik dhe mbështetës.

Stafi në kuadër të Policisë duhet të jetë i ranguar në nivelin e njëjtë me stafin e Gjykatës dhe Prokurorisë, prandaj propozojmë rankimin siç është bërë për stafin e Gjykatave dhe Prokurorisë

- **Ligji për pensionimin e parakohshëm**

Duke parë se Policia e Kosovës, për nga themelimi është ndër policitë më të reja në rajon dhe më gjere, por për nga mosha e zyrtarëve të saj pothuajse se është ndër më të vjetrat. Ashtu siç e kemi theksuar edhe më lartë mosha mesatare e personelit policor ka aritur në katërdhjetë e shtatë (47) vjet dhe vazhdon të rritet si e tillë, ku me këtë moshë është shumë problem realizimi i misionit dhe vizionit policor, si dhe arritja e rezultave pozitive. Andaj bazuar ne nevojat per rinimin e PK-se, kerkohet aprovimi i Ligjit per pensionim te parakohshem sipas rekomandimeve të dhëna nga PK-ja ku është bërë një dokument-analizë për mënyrën e implementimit të Ligjit për pensionimin e parakohshëm të zyrtarëve policor ku ka parapara këtë implementim në faza të caktuara.

- **Pagesa e orëve shtesë në vazhdimësi**

Duke e ditur se natyra e punës së punonjësve të PK-se, me angazhime shtesë dhe në orare të ndryshme, përfshirë atë në vikende e ndrrime të natës, e shpesh herë edhe me orare 12 orësh, kalohet norma e punës dhe krijohen orë shtesë për punonjësit e PK-se dhe për këtë bazuar në procedurat e parapara ligjore kërkohet edhe pagesa në vazhdimësi e orëve shtesë.

Pagesat me kohë dhe në vazhdimësi do të krijojnë edhe një motiv shtesë për punë për punonjësit, në të kundërtën do të praqitet vështirësi angazhimi i tyre dhe realizimi i operacioneve policore.

- **Sigurimi/pagesa e shujtës**

Gjithashtu jemi të obliguar për sigurimin e një shujte për punonjësit e PK-se, e cila në këto kushte të vështira do të ndihmonte punonjësit e PK-se në mirëqenjejn e tyre. Duke ditur vështirësit e të ushqyerit në kohë dhe orare të ndryshme kërkohet së paku të kenë mbulesë pagesën e shujtes.

- **Mbulimi i shpenzimeve të udhëtimit, apo sigurimi i transportit**

Një numër i madh i punonjësve të PK-se janë të transferuar në detyra dhe njësi të ndryshme, për shkak të nevojës dhe natyrës së punës në institucionin policor e të cilët udhëtojnë me kilometra të tëra. Andaj vlerësohet si shumë e nevojshme mbulimi i shpenzimeve të udhëtimit që policët tanë të profileve të ndryshme, të mos mbesin në rrugë duke pritur transporte apo duke bërë autostope në rrugë, pasi ata udhëtojnë në orare të ndryshme dhe në mungesë të transportit mund të hasen në rrugë nga persona të ndryshëm. PK-ja mbulon vetem disa rajone me pak linja kryesore me nga një autobus dhe nuk ka zgjidhje transporti për të gjithë punonjësit e PK-se.

Pasi që kemi realizuar disa takime me z.Xhelal Sveçla Ministër i MPB-së, kemi vlerësuar që të relizojmë një takim zyrtar edhe me Juve z.Kryeministër dhe me Minisitrin e Financave, me qëllim të diskutimit dhe njoftimit me kërkesat dhe nevojat e pjestarëve të policisë. Jemi të gatshëm të bashkëpunojmë dhe të bashkëveprojmë në jetësimin e projekteve për përmirësimin e mirëqenjes në Policinë e Kosovës.

- **Ndërhyrja e Thesarit të shtetit në anëtarësinë e Sindikatës**

Poashtu ndërhyrja e fundit që është bërë nga Thesari në Sindikatën e Policisë së Kosovës, e që konsiderojmë se është e kundërligjshme, me që rast kuotën e anëtarësisë nuk e kanë bartë në llogarinë e sindikatës sipas listës së pagave dhe evdincës që e kanë poseduar nga sindikata, duke u thirr në një njoftim paraprak me afat pesë(5) ditor, pa konsultim paraprak me ne.

Vlerësojmë se pas kësaj ndërhyrje është e nevojshme që të realizojmë një takim urgjent për t'u sqaruar dhe eliminuar paknaqësit e anëtarësisë si dhe kriteret me të cilat vepron Sindikata e Policisë së Kosovës për anëtarësime dhe ç'anëtarësime.

Mbesim me shpresë se kërkesa jonë do të has në mirëkuptim të plotë nga ana e Juaj dhe do të realizohet sa më shpejt.

Me respekt:

Imer Zeqiri

Kryetar i Sindikatës së Policisë së Kosovës

